



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
AKADEMIA E SIGURISË

STRATEGJIA ZHVILLIMORE
E
AKADEMISË SË SIGURISË

Miratuar me Vendim nr. 37, dt. 17.5.2022 të Senatit Akademik



AKADEMIA E SIGURISE
SENATI AKADEMIK

Nr. 81. Prot.

Tiranë më 17.05.2022

VENDIM Nr. 57

Senati i Akademisë së Sigurisë i mbledhur sot më datën 17.05.2022 mbasi diskutoi rreth Draftit të Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë, të përgatitur nga grupi i punës, në bashkëpunim me ekspertët Filandezë dhe Estonezë;

VENDOSI:

1. Miratimin e draftit të Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë dhe planit të veprimit për periudhën 2022-2025.
2. Kryetari i grupit të punës të bëjë korigjimin e vërejtjeve të Senatit Akademik dhe shpërndarjen e draftit në të gjitha njësitë strukturore të Akademisë së Sigurisë.

Kryetari i Senatit
Bilbil MEMAJ



Tiranë më 17.05.2022



AKADEMIA E SIGURISË

URDHËR

Nr. 265 datë 7/12. 2021

Për

Ngritjen e grupit të punës, për përgatitjen e Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë për periudhën 2022 - 2025

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"; Nenit 28; 29 pika b, të Rregullores së Policisë, miratuar me VKM nr. 750 date 16. 09. 2015.(i ndryshuar)

Në zbatim të Rregullores së Akademisë së Sigurisë.

Me qëllim përgatitjen e Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë për periudhën 2022 - 2025,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë, për periudhën 2022 – 2025, me përbërjen si më poshtë:

1. Drejtues Xhavit SHALA, kryetarë
2. Prof. Asc Doktor Qetsor ORHAN, anëtarë
3. Albert HITOALIAJ, anëtarë
4. Drejtues Ervin HODAJ, anëtarë
5. Kryekomisar Kostandin NACO, anëtarë

2. Grupi i punës, në bashkëpunim me drejtuesit dhe ekspertet e Projektit të Binjakëzimit, të përgatisë Strategjinë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë, për periudhën 2022 – 2025, brenda muajit Shkurt 2022.

3. Për njohjen e zbatimit të këtij urdhri ngarkohen; Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Kolegji Policor, Drejtoria e Planifikimit e Kontrollit, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Qendra Kërkimore Shkencore.

Drejtori /Rektori

Drejtues i Lartë Bilbil MEMAJ

Në mungesë dhe me autorizim

Drejtues i Parë Gentian SHKURT



PËRMBAJTJE

1. Hyrje
2. Metodologjia
3. Misioni
4. Vizioni
5. Vlerat
6. Objektivat strategjikë
7. Plani i veprimit
8. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi

1. HYRJE

Arsimimi i lartë po merr përherë e më shumë rëndësi në profesionin e policimit. Përballja me natyrën shumëdimensionale dhe të sofistikuar të krimin kërkon një qasje bashkëpunuese mes arsimimit me trajnimet profesionale dhe kërkimit shkencor për të gjetur përgjigje përparimtare për problemet komplekse. Në kushtet e sotme policisë i nevojiten analiza të qëndrueshme dhe metodologji vlerësimi kërcënimesh për të planifikuar përgjigjen e përshtatshme policore. Sfida e edukimit policor është përmirësimi i arsimimit akademik me një proces trajnimi profesional të vazhdueshëm të përshtatshëm për përgatitjen e profesionistëve për një shërbim policor dinamik dhe të përshtatshëm me ambientin në ndryshim. Ambienti i ndryshueshëm i sigurisë, imponon nevojën e gjetjes së përgjigjeve konkurruese për një grup burimesh të kufizuara. Krimi është sofistikuar dhe duhet luftuar edhe me dije. Arritja e përsosmërisë në sistemin arsimor, është mjeti më i rëndësishëm i suksesit tonë të ardhshëm. Për këtë është e domosdoshme zhvillimi i një sistemi arsimor policor sa më cilësor.

Strategjia zhvillimore e Akademisë së Sigurisë është rezultat i punës së stafit të Qendrës Kërkimore Shkencore (QKSH) të Akademisë së Sigurisë (AS), stafit akademik të AS-së dhe bashkëpunimit me ekspertët finlandezë e estonezë të Projektit të Binjakëzimit të AS-së. Grupi i përbashkët i punës, përmes kësaj *Strategjie*, dëshiron t'i hapë rrugë një qasjeje moderne të arsimimit policor nëpërmjet AS-së, për një edukim dhe zhvillim profesional të qëndrueshëm në fushën e policimit dhe sigurisë.

AS përmes programeve ku ndërthuren arsimimi bazë policor me trajnimet, arsimimin e lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës, dhe kërkimin shkencor, përmbush nevojën e një zhvillimi arsimor e profesional policor bashkëkohor, afatgjatë e të qëndrueshëm, për përgatitjen e specialistëve ekzistues dhe të ardhshëm të Policisë së Shtetit, e strukturave të tjera të sigurisë publike.

Falënderojmë të gjithë anëtarët dhe ekspertët e angazhuar në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, të bindur se ekspertiza dhe kontributi i ofruar mundësuan që Akademia e Sigurisë të ketë një vizion të qartë e konkret zhvillimi për vitet e ardhshme.

2. METODOLOGJIA

Strategjia zhvillimore e AS-së është bazuar në parimet që burojnë nga *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, legjislati në fuqi që normon veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe arsimin e lartë publik e kërkimin shkencor, në Republikën e Shqipërisë si dhe strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit që lidhen me arsimimin dhe sigurinë. Strategjia bazohet edhe në praktikën më të mirë të institucioneve të akredituara në fushën e sigurisë publike, duke aplikuar standardet më të avancuara ndërkombëtare.

Procesi i planifikimit strategjik është kryer i bazuar në këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesuara, me institucione shtetërore, me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë.

Metodologjia e hartimit të strategjisë u zhvillua mbi këto hapa:

- analizë dhe studim i ndikimit të nivelit të arsimimit të kryerja e punës policore;

- studim modelesh prej institucioneve të arsimit të lartë të fushës brenda dhe jashtë vendit;
- grumbullim i literaturës teorike e ligjore;
- analizë krahasuese e gjendjes aktuale, arritjeve dhe objektivave për të ardhmen;
- reflektim mbi strategjitë e Policisë së Shtetit dhe akteve ligjore, mbi nevojën e përmirësimit të arsimit policor;
- rekomandime nga vlerësimet, studimet në raportet e misioneve partnere që kanë asistuar Policinë e Shtetit, në periudha të ndryshme kohore dhe formate të ndryshme;
- anketime dhe intervista me drejtues, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit, ish-studentë e kursantë, etj.

3. MISIONI

“ Transmetimi i dijeve nëpërmjet arsimit dhe kërkimit ”

Misioni kryesor i Akademisë së Sigurisë është zhvillimi dhe transmetimi i dijeve me anën e arsimit dhe kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera ligjzbatuese.

Akademia e Sigurisë, si institucion përgjegjës i vetëm i arsimit të lartë publik policor, në të tre ciklet e studimeve universitare, ka për mision formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit e për personat fizike e juridike në fushën e rendit e të sigurisë publike.

Akademia e Sigurisë, në vartësi dhe funksion të Policisë së Shtetit, është një institucion publik i arsimit të lartë, dhe zbaton përveç ligjit të Policisë së Shteti edhe ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore që rrjedhin në zbatim të tyre.

4. VIZIONI

“ Të jemi një akademi moderne në nivel rajonal e më gjerë, të krahasueshëm me cilësinë evropiane të arsimit në fushën e sigurisë ”

Akademia e Sigurisë ka për vizion një qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të arsimit, kërkimit, trajnimit dhe kualifikimit policor në fushën e sigurisë publike.

Akademia e Sigurisë synon që të njihet nga palët kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit, si institucioni parësor për të gjitha nivelet e arsimit në sektorët e sigurisë publike.

Konceptimi i saj organizativ, infrastrukturor e në kurrikula, me programe ku ndërthuren arsimimi bazë policor me trajnimet, kualifikimet institucionale dhe arsimimi i lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës, synon një zhvillim arsimor profesional policor afatgjatë e të qëndrueshëm.

Synojmë përgatitjen e specialistëve të sigurisë me kulturë e dije të nivelit universitar bashkëkohor, të krahasueshëm me akademitë policore Perëndimore duke e shndërruar AS-në në një institucion të arsimit të lartë publik, lider në fushën e policimit dhe të sigurisë.

5. VLERAT

Strategjia zhvillimore e AS-së bazohet në këto vlera:

Përgjegjshmëria. Në themel të punës dhe veprimtarisë së saj Akademia e Sigurisë mbështetet në parimin e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies ndaj publikut. Punonjësit e Akademisë (ata me status policorë, personeli akademik dhe punonjësit administrativ) mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet e tyre, të cilat bien ndesh me zbatimin e ligjit.

Ndershmëria. Stafit akademik dhe ai mbështetës, si ata me status policorë, personeli akademik dhe punonjësit administrative, veprojnë *ndershmërisht* në aspektin profesional dhe atë të jetës së përditshme, si punonjës të një institucioni publik model. Të gjitha proceset e AS-së janë tërësisht *transparente* për të gjithë palët e interesit. AS thekson rëndësinë e përgatitjes së një gjenerate profesionistësh të fushës së policimit dhe sigurisë publike, të aftë për përmbushjen e misionit të tyre, me etikë dhe integritet.

Liria akademike dhe e kërkimit. Stafit akademik gëzon lirinë e mendimit, të shprehjes akademike e kërkimore. Ai respekton normat etike dhe ka në themel të punës së tij akademike e kërkimore respektin ndaj pronësisë intelektuale. Veprimtaria kërkimore merr në konsideratë në vazhdimësi parimet e *Kartës Europiane* për kërkuesit shkencorë dhe *Kodin e sjelljes për rekrutimin e kërkuesve shkencorë*.

Mosdiskriminimi. Si parim themelor i të drejtave të njeriut mosdiskriminimi mbi bazën e gjinisë, moshës, origjinës etnike, kombëtare ose sociale, fesë ose besimit, orientimit seksual, gjuhës, paaftësisë, mendimit politik apo gjendjes sociale dhe ekonomike, zbatohet në të gjitha drejtimet dhe proceset si për stafin akademik, shkencor, mbështetës dhe studentët e kursantët.

Mirëqenia e stafit dhe e studentëve. AS ofron një ambient stimulues për punë akademike e kërkimore shkencore, me mjetet e përshtatshme, ambiente bashkëkohore mësimdhënie e studimi, financimin e nevojshëm, mundësi të barabarta dhe garanton respektimin e rregullave kombëtare apo sektoriale që lidhen me mbrojtjen e shëndetit dhe ruajtjen e sigurisë përgjatë veprimtarisë akademike, kërkimore e hulumtuese.

6. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

"Sfida është ndryshimi"

1. Akademia e Sigurisë synon të jetë lider në arsimim, kërkim shkencor e trajnim në fushën e policimit dhe të sigurisë publike në vend, në mënyrë që nga kjo të përfitojë e gjithë shoqëria.
2. Respektimi i parimeve bazë akademike, për ta shndërruar AS-në në një institucion konkurrues dhe tërheqës për studentët, mes institucioneve të arsimit të lartë në vend.
3. Hartimi e përditësimi i programeve dhe kurrikulave sipas kërkesave dhe standardeve bashkëkohore si dhe inovacioni e kërkimi shkencor do të luajnë një rol të rëndësishëm, duke siguruar akreditimet periodike.
4. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të afta për të gjeneruar dhe shpërndarë njohuri bashkëkohore të fushës së policimit dhe të sigurisë publike.

5. Zhvillimi i kapaciteteve infrastrukturore si domosdoshmëri për plotësimin e misionit të AS-së.
6. Përmirësimi i ndërveprimit të strukturave ekzistuese duke nxituar bashkëpunimin dhe koordinimin e brendshëm institucional të njërive bazë dhe atyre kryesore.
7. Bashkëpunimi dhe koordinimi efektiv me institucione të tjera të arsimit të lartë publik dhe jopublik, brenda e jashtë vendit, me institucione, akademi, kolegje arsimore policore të BE-së dhe vendeve partnere, etj.

7. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në *Strategjinë zhvillimore të AS-së*. Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie përmban:

- objektivat strategjike;
- objektivat specifike;
- aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
- institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
- afatet kohore për realizimin e secilit objektiv;
- burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
- treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

8. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

AS-ja është institucion përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e kësaj *Strategjie*. Zbatimi i strategjisë zhvillimore arrihet përmes realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike dhe aktiviteteve të parashikuara në *Planin e veprimit*. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe përmbushjes së aktiviteteve përkatëse janë pjesë integrale e kësaj *Strategjie zhvillimore të AS-së* dhe komponent kryesor i procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e *Strategjisë*, dhe për të matur realizimin e objektivave. Procesi i zbatimit të strategjisë zhvillimore do të monitorohet e vlerësohet çdo vit nga Bordi i Administrimit. Ky proces duhet të përfshijë tregues të qartë të progresit të bazuar në raportet periodike të njërive akademike.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë Zhvillimore janë:


kapacitetet institucionale; treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës pesëvjeçare; burimet e informacionit dhe instrumentet matëse; shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

Treguesit përfundimtarë, por duke mos u kufizuar vetëm në ta, janë:

Numri i akteve ligjore e nënligjore që kanë hyrë në fuqi pas miratimit të *Strategjisë*; organizimi i brendshëm; numri i marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe të nënshkruara me institucione homologe; raportet e monitorimit dhe të vlerësimit të *Strategjisë*; numri i trajnimeve të realizuara; numri i kursantëve dhe studentëve të certifikuar e të diplomuar; numri i projekteve të realizuara; gjendja e infrastrukturës brenda AS-së; akreditimi i


programeve të reja dhe riakreditimi i programeve ekzistuese; publikimet shkencore të AS-së; numri i aktiviteteve të realizuara në mbështetje institucioneve publike apo private.

Grupi i punës për përgatitjen e “Strategjisë zhvillimore të Akademisë së Sigurisë”

Drejtues Dr. Xhavit **SHALA**, kryetar 

Prof. asc. dr. Qetsor **ORHAN**, anëtar 

Drejtues Ervin **HODAJ**, anëtar

Kryekomisar Kostandin **NAÇO**, anëtar 

Dr. Albert **HITOALIAJ**, anëtar

Në përbërje të grupit të punës ishin edhe këshilltarët finlandezë e estonezë pjesë e projektit “Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë – TWINNING IPA 2018”:

Prof. dr. Kimmo **HIMBERG**, këshillues

Police University College Director (retired 1st January 2022) / Finland

Politseikolonel Kalvi **ALMOSEN**, këshillues

Politsei- ja piirivalvekolledži direktor / Estonia